
KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 16 / 03 / 2021, bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH, lidhet kjo kontratë për dhurim kuotash.

NENI 1


Palët kontraktuese

- 1.1. Shoqëria "M . I . A" SHPK, me nr. NUIS L32117002H, përfaqësuar nga administratori z. Florjan Mumajesi, shtetas shqiptar, lindur më 23/08/1982, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I20823122B, nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si "DHURUESI";**
- 1.2. Z. Andon Hidersha, shtetas shqiptar, lindur më 21.03.1987 në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I70321070R,**
- dhe
- 1.3. Z. Even Mediu, shtetas shqiptar, lindur më 20/01/1995, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës me numër BF0170000, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar bashkërisht si "PRANUESIT E DHURIMIT".**

NENI 2

Objekti i kontratës

- 2.1.** Objekt i kësaj kontrate është kalimi i së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit, nga Dhuruesi te Pranuesit e Dhurimit, të kuotave/pjesëve, që përfaqësojnë 8 % të kapitalit, që Dhuruesi zotëron në shoqërinë tregtare "PROPER PIZZA PRODUCTION" SHPK me nr. NUIS L71403037J, të ndara respektivisht sipas pikës 2.2 më poshtë:



1

-
- 2.2. Z. Andon Hidersha** i dhurohet një kuotë/pjesë që përfaqëson **5 %** të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale ALL 5 (pesë Lekë);
- Z. Even Mediu** i dhurohet një kuotë/pjesë që përfaqëson **3 %** të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale ALL 3 (tre Lekë).

NENI 3

Baza Ligjore

Kjo kontratë hartohet duke u bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH dhe nenin 73 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" – i ndryshuar.

NENI 4

Vlera e dhurimit

- 4.1.** Dhuruesi ia dhuron pa asnjë kundër shpërblim kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate, Pranuesve të dhurimit.
- 4.2.** Vlera totale e kuotave/pjesëve të dhuruara është **ALL 8** (tetë Lekë).

NENI 5

Deklarime të palëve

- 5.1.** Dhuruesi garanton se kuotat/pjesët e tij në kapital, nuk janë lënë peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi to.
- 5.2.** Pranuesit e dhurimit, deklarojnë se pranojnë t'i dhurohen kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate.
- 5.3.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pronësia mbi kuotat/pjesët e specifikuara në nenin 2 të kësaj kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesit e dhurimit.
- 5.4.** Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesit e dhurimit do të bëjnë regjistrimin e saj pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Biznesit).
- 5.5.** Pas nënshkrimit të kontratës, Dhuruesi humbet të gjitha të drejtat e pronësisë mbi kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate.



2

NENI 6
Hyrja në fuqi

- 6.1.** Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 6.2.** Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me interpretimin e kontratës, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.
- 6.3.** Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

PALËT KONTRAKTUESE

DHURUESI
SHOQËRIA "M . I . A" SHPK
Përfaqësuar nga administratori
Z. FLORIAN MUMAJESI
FLORIAN MUMAJESI HOLDING
NUI5:L32117002H



PRANUESIT E DHURIMIT

ANDON HIDERSHA



EVEN MEDIU

Even Mediu

